



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:018953 C. nr. 336/2022
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05514231

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Atthe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.H. nga Prizreni, të cilin me autorizim i përfaqëson K.M. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. Përfaqësuese Ligjore e Komunës, me objekt kontesti kompensimin i pagës jubilarë, vlera e kontestit 253.45 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësorë, me datë 27 Mars 20224 mori këtë:

A K T G J Y K I M
- Pa shqyrtim kryesor të çështjes -

- I. Miratohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.H. nga Prizreni, dhe detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit, në emër të kompensimit të pagës jubilarë, për 10 vite të përvojës së punës t'i paguaj shumën prej 210.50€ (dyqind e dhjetë euro e pesëdhjetë cent), me kamatë ligjore për 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (31.01.2022), e deri në përmbushjen definitive të gjitha këto afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- II. Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë për kompensimin e pagës jubilarë në shumë prej 42.50 (katër dhjetë e dy euro e pesë dhjetë cent), përtej shumës së gjykuar si në I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si e pa bazuar.
- III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 € (njëqind e njëzet e katër euro), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij K.M. nga Prizreni, në këtë Gjykatë me datën 31.01.2022 ka parashtruar padi për kompensimin e pagës jubilarë kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit.

Në padi, i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të punës në SHFMU ‘‘Dëshmorët e Zhurit’’ në Zhur, dhe se nuk është paguar paga jubilarë, bazuar në nenin 35 par.8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më datën 18.04.2017, ku punëtorët në vitet jubilarë të punësimit për 10 vite të përvojës së fundit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 50 % të një page bazë. Kjo e drejtë i takon edhe me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më

datën 22.01.2021. Ky fakt vërtetohet në bazë vërtetimit të viteve të punës të lëshuar nga SHFMU - “Dëshmorët e Zhurit” në Zhur, ku paditësja ka mbi 14 vite përvojë pune, andaj i takon pagesa 50 % të një page bazë.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Ka theksuar se pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i pagës bazë është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi që në këto dispozita shkruan kuartë për përfituesit e të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga kjo kontratë, ndërsa paditësi nuk ka ofruar prova që është anëtarë i sindikatës dhe i ka kaluar procedurat administrative sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës dhe nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, po ashtu me këto veprime i shkakton Komunës së Prizrenit shpenzime të mëdha, sepse e obligon që t’ia paguajë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Po ashtu thekson se në mungesë të alokimit të mjeteve nga Ministria e Arsimit, e paditura nuk mund të veprojë në kundërshtim me planifikimin buxhetor. Gjithashtu ka theksuar se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me nenin 90 para.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarave, dhe në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënëse dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, andaj nga të gjitha të cekurat ka kërkuar që gjykata të nxjerr aktgjykim dhe të refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës i kimisë në SH.F.M.U. “Dëshmorët e Zhurit”, në Prizren, e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të vërtetimit të lëshuar nga e paditura.

Nga vërtetimi me numër të referencës 08/20 të datës 13.01.2020, të lëshuar nga ana e të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi A.H. është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe ka 14 vjet përvojë pune, dhe realizon të ardhura personale në muaj dhe atë pagën bruto në vlerë 506.90, ndërsa atë neto 453.31 euro.

Në bazë të përgjigjes së kthyer nga ana e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me numër të protokollit 4540 të datës 11.12.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se Mësimdhënës në Shkollë të mesme të Ulët paga bazë në shumë është 421.00 euro.

Përgjigja e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, dhe vërtetimi i lartpërmendur, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të Nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”

Andaj meqë vërtetimi i përvojës së punës e lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e cila si e tillë është e pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që, vërtetimin e lëshuar nga ana e SH.F.M.U, “Dëshmorët e Zhurit” në Zhur, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me përvojën në punë, si dhe përgjigjes nga MASHT-së, lidhur me pagën bazë, Gjykata ju falë besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, më saktësisht duke marrë për bazë periudhën se kur pala paditëse ka arritur vitin jubilar prej 10 vitesh, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017.

Me nenin 35 par.8, nën par.8.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është paraparë se *“Punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: “për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si mësimdhënës t’ia paguaj kompensimin e pagës jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, ndërsa shumën e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe përgjigjes së MASHT-së, lidhur me pagën bazë.

Në anën tjetër, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar kërkesën e paditësit në shumën prej 42.95 euro, pasi që erdhi në përfundim duke i njohur vetëm përqindjen në pagën mujore bazë (pa shtesa). Gjykata vlerëson se paga mujore me shtesat tjera të paraqitura në listën e pagave dhe atë pagesa e pagave jubilarë, nuk mund të jenë objekt përfitimi nga paditësi, pasi që legjislacioni aktual i punës ka bërë dallimin e pagës dhe shtesave tjera në punë. Me nenin 55 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, është paraparë se *“Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuari i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me Kontratën e Punës”*. Pra përcaktimi ligjor nga ky nen, ndan atë çka nënkupton pagë dhe shtesa nga paga.

Lidhur me kundërshtimet e të paditurës me përgjigje në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike

apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë 31.01.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet 104.00 euro për përpilim e padisë dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, gjithsej shumën prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
C. nr. 336/2022 datë 27 Mars 2024

B. profesional
Ilir Sërtollaj

Gj y k a t ë s i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.